# RAPORTI PERFUNDIMTAR I

# GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

# PËR PROGRAMIN E STUDIMIT

## BACHELOR NË GJUHË DHE LETËRSI TURKE

## TË SHKOLLËSSË LARTË PRIVATE “HËNA E PLOTË” (BEDËR)

Ekspertë: **1.Prof.dr. Ferit Duka**
**2.Doc. Dr. Lindita Xhanari**

**Mars 2013**

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
## Për Programin e studimit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Turke

### ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

**Misioni** i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Turkenë programin Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Turke, është t'i përgatisë studentët me dituritë themelore nga teoria gjuhësore dhe metodologjik, si dhe t'i aftësoje ata për zbatimin e teorisë në mësimin praktik. Nga ana tjetër ky program mësimor synon edhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbare shoqërisë.

**Objektivat** e programit kanë të bëjnë me edukimin dhe përgatitjen e studentëve si profesionistë, në mënyrë që ata të njihen me letërsinë turke dhe atë botërore, të kenë eksperiencë në mësimdhënien e turqishtes për të huaj, si dhe të jenë në gjendje të shtojnë shije dhe estetikë letrare në ambientin që i rrethon.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardet/kriteret | Vlerësimi i IAL sipas standardit/ kriterit[1] |
|---|---|
| **I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;<br>**Kriteri 4** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;<br>**Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;<br>**Kriteri 6** Programet e studimeve hartohen në | **Kriteri 3.** Programi i studimit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Turke është në përputhje të plotë me objektivat dhe misionin e këtij Institucioni të Arsimit të Lartë. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke, ofron një program studimi, i cili është në përputhje me "Ligjin mbi arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". Programi i ofruar nga ky departament, u jep studentëve një formim intelektual të mirë përcaktuar, si dhe i ndihmon ata të zotërojnë njohuri të |

[1] GVJ duhettështprehen me shkrimpërtëgjithakriteret. Në fund tëkritereveduhettëjapëmendimin e tijpërpërmbushjen e standarditnëtërësi.

| | |
|---|---|
| përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. | qëndrueshme, të cilat do të jenë baza e sigurt e karrierës së tyre, për vitet e mëpastajme.<br>**Kriteri 4.** Programi i studimit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Turke ka si objektiv parësor edukimin dhe përgatitjen profesionale të studentëve si mësues profesionistë në procesin e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë turke. Gjithashtu ai synon përgatitjen e tyre edhe si përkthyes e studiues arkivash. Ky objektiv reflektohet qartë ne këtë program studimi.<br><br>**Kriteri 5.** Departamenti është përpjekur të hartojë një program mësimor që përputhet me nevojat e tregut të punës. Bazuar në investigimet e tyre, rezulton se me realitetin e krijuar në Shqipëri, për shkak të hapjes së një morie kolegjesh turke, si dhe shtimit të firmave të mëdha turke, është rritur kërkesa për mësues të kësaj gjuhe, si dhe është shtuar nevoja për përkthyes e nëpunës që dinë këtë gjuhë në këto firma. Si rrjedhojë, njohja e turqishtes u krijon studentëve mundësi të mëdha integrimi në tregun e punës.<br>**Kriteri 6.** Politikat zhvillimore të Departamentit, në hartimin e këtij programi mësimor, janë mbështetur në zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe në kërkesat e tregut të punës. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;<br>**Kriteri 3** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit; | **Kriteri 1.** Programi i studimit Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Turke është në përputhje të plotë me misionin e përgjithshëm të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër), si dhe me risitë që synon të sjellë ky institucion në Shqipëri. Kjo degë, synon jo vetëm përthithjen e studentëve me rezultate të larta, që do të ndikonte në rritjen e cilësisë, por në njëfarë mënyre edhe një prejardhje gjeografike të larmishme të studentëve dhe lektorëve. Kjo është edhe nga një nga risitë më pozitive të sjella nga strategjia për zhvillim e ndjekur nga ky institucion arsimor.<br>**Kriteri 2.** Programi i studimit të ciklit të parë është i bazuar në Kartën e Bolonjës, dhe si i tillë synon pajisjen e studentëve, sipas niveleve, me njohuritë bazë krejtësisht të nevojshme për profesionin, mbështetur në një metodologji të saktë. |

| | |
|---|---|
| | **Kriteri 3.** Programi i aplikuar në këtë degë mundëson që studenti pas kryerjes së studimeve të jetë i pajisur me disa profesione dhe specialitete, të cilat janë të përshtatshme për tregun e punës, si: mësues, përkthyes, studiues etj. |
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;<br>**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:<br>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;<br>b. kërkesat e punëdhënësve;<br>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | **Kriteri 1.** Departamenti synon të orientojë programin mësimor të degës, si dhe kërkimin shkencor, sipas nevojave të tregut, duke studiuar të gjitha hapësirat që krijohen prej tij. Për këtë arsye në program janë parashikuar edhe lëndë me formim të përgjithshëm, me qëllim që studentët t'i përshtaten tregut të punës.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Medias, ka monitoruar në vijimësi tregun kombëtar dhe rajonal të punës dhe ka analizuar:<br>- Kërkesat e kolegjeve dhe qendrave të mësimit të gjuhës së huaj për mësues të gjuhës turke.<br>- Kërkesat e firmave të mëdha turke, që operojnë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit, për përkthyes dhe punonjës të tjerë që kanë njohuri në gjuhën turke.<br>- Numrin e studentëve të regjistruar, si dhe kërkesat për t'u regjistruan në vitet paraardhëse, në universitetet që kanë të njëjtin program studimi. |
| **Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;<br>**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. | **Kriteri 1.** Programi i hartuar nga ky Departament rezulton të jetë në përputhje me politikat kombëtare të parashikuara në planin strategjik mbi arsimin e lartë në Shqipëri dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Përkundrazi, nëpërmjet lëndëve me karakter historik, ai synon qartësimin dhe vlerësimin e marrëdhënieve historike e kulturore, e figurave të shquara që kanë kontribuar në kulturën e dy vendeve.<br><br>**Kriteri 2.** Programi i ofruar në ketë degësynon ruajtjen e vlerave kombëtare. Veç kësaj, për shkak të përbërjes heterogjene të studentëve të regjistruar, që vijnë nga 14 |

| | |
|---|---|
| | shtete të ndryshme, nëpërmjet këtij programi bëhet edhe promovimi i vlerave kulturore, i traditës shqiptare e me gjerë. |
| **Konkluzione të GVJ:** Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në bashkëbisedimin që patëm me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, konstatojmë se:<br>1. Ky program studimi është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër). Ai u jep studentëve një formim intelektual të mirëpërcaktuar, si dhe i ndihmon ata të zotërojnë njohuri të qëndrueshme, të cilat do të jenë baza e sigurt e karrierës së tyre, për vitet e mëpastajme.<br>2. Ky program studimi është në përputhje të plotë me strategjinë për zhvillim të këtij institucionit. Kjo degë, synon jo vetëm përthithjen e studentëve me rezultate të larta, që do të ndikonte në rritjen e cilësisë, por në njëfarë mënyre edhe një prejardhje gjeografike të larmishme të studentëve dhe lektorëve. Kjo është edhe nga një nga risitë më pozitive të sjella nga strategjia për zhvillim e ndjekur nga ky institucion arsimor.<br>3. Ky program studimi, bazuar edhe në verifikimin e tregut aktual të punës, në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit, synon të plotësojë nevojat e këtij tregu. Si rezultat i monitorimit të bërë nga ana e Zyrës së Medias, së këtij Institucioni, rezulton se studentët që përfundojnë këtë program mësimor, i përshtaten krejtësisht tregut të punës, të cilit i nevojiten:<br>- Mësues të gjuhës dhe letërsisë turke (në Kolegjet turke dhe në Qendrat e mësimit të gjuhëve të huaja)<br>- Përkthyes të gjuhës turke (në Firmat e mëdha turke që operojnë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit)<br>- Studiues shkencorë në arkiva<br>4. Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare, përkundrazi, për shkak të përbërjes heterogjene të studentëve të regjistruar, që vijnë nga 14 shtete të ndryshme, nëpërmjet këtij programi bëhet edhe promovimi i vlerave kulturore, i traditës shqiptare e me gjerë.<br><br>Pas kësaj analize, grupi ynë i vlerësimit konstaton se programi i ofruar i përmbush të gjitha standardet e kërkuara në pikat: I: I.1, I.2/II: II.1, II.2 dhe e miraton atë. | |

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

**Tregues të matshëm:**

☑ Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Fakulteti i Filologjisë dhe i Edukimit ka këto organe dhe autoritete drejtuese:

- Dekani
- Kancelari
- Këshilli i Fakultetit

- Këshilli i Administrimit të Fakultetit
- Departamenti
- Përgjegjësi i Departamentit

Nga takimet me drejtues të këtij fakulteti, rezulton se të gjitha këto nivele drejtuese, janë në funksionim të plotë.

☑ Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet

- **Dekani**: emërohet me propozim të Rektorit dhe me miratim të Këshillit të Lartë, për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Marrëdhëniet ndërmjet tij dhe personit juridik, përcaktohen në kontratën e punës, të cilën e vërtetuam në Zyrën e Burimeve Njerëzore. Aktualisht, Dekan i këtij fakulteti është Dr. Ahmet Ecirli.
- **Zv. Dekani**: propozohet nga Dekani dhe emërohet nga rektori, për një kohëzgjatje 4-vjeçare.
- **Këshilli i Fakultetit**: është organ kolegjial vendimmarrës, që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve, veprimtarinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor të fakultetit. Ai përbëhet nga: dekani, përgjegjësit e departamenteve dhe nga një anëtar i stafit akademik për çdo departament të zgjedhur nga këshillat e departamenteve përkatëse. Kohëzgjatja e Këshillit është 4 vjet. Ai mblidhet me thirrjen e Dekanit në fillim dhe në mbarim të semestrit. Kancelari i fakultetit ka detyrën e raportuesit ne mbledhjen e Këshillit të Fakultetit. Anëtarët e këshillit të këtij fakulteti janë:
    - Dr. Ahmet Ecirli
    - Dr. Hasan Ugur
    - Dr. Adem Balaban
    - Dr. Bunyamin Çaglayan
    - Doktorant Rudina Guleker
    - Doktorant Ana Uka
    - Ma. Arti Omeri (raportues)

- Këshilli i Administrimit të fakultetit: është organ kolegjial vendimmarrës, që programon e përcakton në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe material në dispozicion të fakultetit. Ai përbëhet nga Dekani dhe Përgjegjësit e

Departamenteve. Kancelari i fakultetit ka detyrën e raportuesit në mbledhjet e Këshillit të Administrimit të Fakultetit. Në këtë fakultet, Këshilli i Administrimit përbëhet nga:

- Dr. Ahmet Ecirli
- Dr. Hasan Ugur
- Dr. Adem Balaban
- Ma. Arti Omeri

- **Departamenti**: është njësia bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Hapja ose mbyllja e departamenteve bëhet me propozim të Senatit dhe me miratim të Këshillit të Lartë. Në Këshillin e Departamentit përfshihet i gjithë stafi akademik i brendshëm, sipas disiplinave përkatëse.
- **Përgjegjësi i Departamentit**: është autoriteti më i lartë drejtues për njësinë bazë mësimore kërkimore. Ai zgjidhet nga Dekani ndërmjet anëtarëve të stafit të brendshëm akademik të Departamentit, miratohet nga Rektori dhe emërohet me vendim të Këshillit të Lartë, për një periudhë 4 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Përgjegjës i Departamentit të Programit studimor: Gjuhë dhe Letërsi Turke është Dr. Adem Balaban.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

## 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

**<u>Pjesa përshkrimore</u>**

**Terma reference**: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër) ndjek politikën e tërheqjes së një stafi të kualifikuar, me grada shkencore e tituj akademikë. Ky standard është përcaktuar edhe në Strategjinë e Zhvillimit të këtij Institucioni. Për këtë, në këtë institucion, është kombinuar punësimi i profesionisteve vendas dhe të huaj me përvojë në fushën akademike.

**<u>Tregues të matshëm:</u>**

☑ Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit

☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 1- 2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të pasqyruara në RVB)

Tabelat 1- 2

| Fakulteti i Filologjisë dhe edukimit<br>Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër) | | Detyra në Dep. | Titulli /Grada | Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër) | | Titulli /Grada | Institucioni ku punon full time |
| 1 | Adem Balaban | Përgj. Departamenti | Dr. | 1 | Adriatik Derjaj | Dr. | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Bunyamin Çaglayan | Lektor | Dr. | 2 | Genciana Abazi Egro | Prof. Ass. Dr. | Instituti i Albanalogjisë |
| 3 | Ceyhun Vedat Uygur | Lektor | Prof. dr. | 3 | Omer Yurekten | Ma. | - |
| 4 | Gulay Yurt | Lektor | Doktorant | | Spartak kadiu | Doktorant | Universiteti I Tiranës |
| 5 | Huseyin Yilmaz | Lektor | Ma. | 5 | Ermal Nurja | | |
| 6 | Sezayi Çoskun | Lektor | Prof. Ass. Dr. | 6 | Dritan Egro | Prof. Ass. Dr. | Instituti i Historisë |
| 7. | Hakan Kacar | Lektor | Ma. | | | | |

Tabela 2

☑ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 3)

Tabela 3

| Titulli | PAE | PAK | RAPORTI |
|---|---|---|---|
| Profesorë | 1 | - | 1/0 |
| Profesorë të As. | 1 | 2 | 1/2 |
| Doktorë | 2 | 1 | 2/1 |
| Docentë | - | - | - |
| Pedagogë (pa tituj) | 3 | 3 | 3/3 |

☑ Të dhënat sipas seksit

| | Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Turke | | |
|---|---|---|---|
| | Numri i PAE | Numri i PAK | Në Total |

| Fakulteti i Filologjisë dhe i Edukimit | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada | Gj | Tituj/ Grada |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Profesorë | M | 1 | - | - | M | 1 |
| Profesorë të asociuar | M | 1 | F/M | 2 | 2M/1F | 3 |
| Doktorë | M | 2 | M | 1 | M | 3 |
| Pedagogë pa tituj | 2M/ 1F | 3 | M | 3 | 5M/1F | 6 |
| Asistentë me Ma. | | | | | | |
| Asistentë pa Ma. | | | | | | |
| | | | | | | |

☑ Të dhëna sipas moshës së personelit

| Dep. i Gjuhës dhe Letërsisë turke | Mosha e personelit efektiv | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 25-35 vjeç | 36-45 vjeç | 46-55 vjeç | 56-65 vjeç | 66-68 vjeç | |
| Profesorë | | | 1 | | | |
| Profesorë të asociuar | | 1 | | | | |
| Doktorë | 1 | | | 1 | | |
| Pedagogë pa tituj | | 3 | | | | |
| Asistentë me Ma. | | | | | | |
| Asistentë pa Ma. | | | | | | |
| | | | | | | |

| Dep. i Gjuhës dhe Letërsisë turke | Mosha e personelit me kontratë | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 25-35 vjeç | 36-45 vjeç | 46-55 vjeç | 56-65 vjeç | 66-68 vjeç | |
| Profesorë | | | | | | |
| Profesorë të asociuar | | 2 | | | | |
| Doktorë | 1 | | | | | |
| Pedagogë pa tituj | | 1 | | | | |
| Asistentë me Ma. | | | | | | |
| Asistentë pa Ma. | | | | | | |
| | | | | | | |

☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Nga takimet në Zyrën e Burimeve Njerëzore verifikuam kontrata të rregullta pune, si për personelin e brendshëm, ashtu edhe për personelin e jashtëm. Marrja në punë e stafit

akademik bëhej mbi bazën e një procedure të mirëpërcaktuar dhe sipas ligjeve ne fuqi. Ky proces ndiqte 4 hapa kryesorë ku përfshihej:

- Kërkesa për personel nga Departamenti dhe shpallja e lajmërimit në web nga ana e Zyrës së Burime Njerëzore
- Dorëzimi i dokumenteve nga ana e kandidatëve ne Zyrën e burimeve Njerëzore
- Ngritja e Komisionit të Vlerësimit, shqyrtimi i dokumenteve të kandidatëve dhe hartimi i raportit të Vlerësimit për kandidatët e paraqitur.
- Vendimi i Këshillit të Administrimit të Fakultetit dhe hartimi i propozimit të tij për në Këshillin e Administrimit të Institucionit. Miratimi final bëhej nga ky këshill.

☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nuk ka të dhëna për stafin ndihmës/administrativ.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardit/ kriterit |
|---|---|
| **III - PERSONELI I INSTITUCIONIT**<br>**Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br>**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;<br>**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;<br>**Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj. | **Kriteri 1.** Institucioni, bazuar në Statutin e tij, ka miratuar një rregullore të qartë punësimi për rekrutimin e personelit të brendshëm dhe të jashtëm. Ai ndjek procedura ligjore transparente dhe në varësi të ligjit shqiptar, bashkërendon procesin e tij të përzgjedhjes me Zyrën Rajonale të Punës. Për këtë, për çdo njoftim për vend të lirë pune, Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas ligjit shqiptar, njofton Zyrën Rajonale të Punës dhe pret edhe aplikimet e saj.<br>**Kriteri 2.** Në përputhje me programin e studimit të ciklit të parë, që u ofrohet studentëve, Institucioni është përpjekur të përzgjedhë një staf akademik të mirë dhe të suksesshëm. Raporti ndërmjeti stafit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, nga verifikimet e bëra, rezulton të jetë 7/6.<br>**Kriteri 3.** Institucioni ndjek procedura ligjore transparente të vlerësimit të personelit akademik. Ai zhvillon anketime të rregullta para çdo sesioni provimesh për të gjithë |

| | |
|---|---|
| | pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm dhe nxjerr në këtë mënyrë vlerësimet për ta.<br>**Kriteri 4.** Zyra e Burimeve Njerëzore, pranë këtij Institucioni, ka krijuar një bazë të dhënash, në formën e dosjeve personale për çdo pedagog të brendshëm dhe të jashtëm. Dosjet përmbajnë dokumentacionin e nevojshëm, i cili është shqyrtuar nga komisioni i ngritur për vlerësimin e tyre gjatë konkurrimit. Kriteret e konkurrimit propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani. Procedurat e zhvillimit të konkursit janë të qarta. Njoftimi fillimisht i dërgohet, sipas ligjit shqiptar, Zyrës Rajonale të punës dhe pas një periudhe prej 5 ditësh shpallet në faqen e web-it të Universitetit. Edhe në rastet e mosrinovimit të kontratës së punës, dosja e hapur për pedagogun, ruhet për një periudhë kohe në zyrën e Burimeve Njerëzore, e më pas dërgohet në Arkivë. |
| **Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;<br>**Kriteri 2** Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;<br>**Kriteri 3** Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;<br>**Kriteri 4** Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor" ose titullin akademik "Docent". | **Kriteri 1.** Zyra e Burimeve Njerëzore, pranë këtij Institucioni disponon të dhëna të hollësishme në lidhje me personelin akademik të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme. Këto të dhëna janë mbajtur në një data bazë, e cila serviret në formë elektronike dhe të printuar. Në këtë mënyrë është krijuar edhe arkivi me të dhënat mbi personelin e brendshëm dhe të jashtëm akademik të punësuar në këtë Departament.<br>**Kriteri 2.** Departamenti disponon listën e plotë të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm për çdo semestër, sipas lëndëve që mbulojnë. Gjithashtu ai ka edhe listën e plotë të personelit ndihmës mësimor-shkencor, si dhe listën e personelit administrativ.<br>**Kriteri 3.** Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit të ri, të brendshëm dhe të Jashtëm, dërgohen fillimisht, sipas ligjit shqiptar, në Zyrën Rajonale të Punës, dhe me pas publikohen në faqen zyrtare të Institucionit në internet. Të gjitha kriteret bëhen publike në gjuhën shqipe dhe angleze, për t'i dhënë mundësi edhe personelit të huaj, që të bëhet pjesë e mësimdhënies në këtë Institucion.<br>**Kriteri 4.** Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke është përpjekur të rekrutojë një staf akademik të kualifikuar, me grada |

| | |
|---|---|
| | shkencore, në një përqindje relativisht të mirë. Ai rezulton të ketë si pedagogë të brendshëm: 1 Prof. dr., 1 Prof. Assoc. Dr., 2 Dr., 3 pedagogë pa tituj, ndërsa si pedagogë të Jashtëm: 2 Prof. Assoc. Dr., 1 Dr. dhe 3 pedagogë pa tituj. Në total, pranë këtij Departamenti punojnë: 7 pedagogë me grada shkencore dhe 6 pedagogë pa grada shkencore. Për më pas synohet një raport më i mirë. |
| **Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;<br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;<br>**Kriteri 3** Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë). | **Kriteri 1.** Institucioni dëshmon seriozitet në angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike të mësimit të turqishtes.<br>**Kriteri 2.** Institucioni, përmes Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike dëshmon për një angazhim optimal për të përmbushur të gjitha nevojat dhe domosdoshmëritë për realizimin cilësor të objektiva të këtij programi studimi.<br>**Kriteri 3**. Institucioni tregon seriozitetin e duhur në çështje të instruktimit, udhëheqjes dhe orientimit të mirë të studentëve. Ky është një proces që fillon që në vitin e parë e deri në përfundim të studimeve. Çdo fillim viti akademik miratohen këshilltarët e studentëve sipas një rregulli të përcaktuar, ku çdo këshilltar nuk ka më shumë se 10 studentë në ngarkim. Gjatë takimit që patëm me studentët e këtij programi mësimor, na rezulton se ata janë mjaft të kënaqur nga fakti se këshilltarët e tyre, si dhe pedagogët që u japin mësim, janë gjithmonë të pranishëm dhe i sqarojnë me hollësi për çdo vështirësi që hasin, duke punuar në grupe të vogla ose edhe individualisht me ta. |
| **Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;<br>**Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara. | **Kriteri 1.** Në mënyrë periodike ky Institucion harton programe te veçanta, që kanë si synim kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik. Këtë ai e realizon nëpërmjet disa mënyrave:<br>- Sponsorizon një herë në vit pjesëmarrjen e personelit në aktivitete shkencore.<br>- Vlerëson dhe stimulon nëpërmjet sistemit të pikëve, që reflektohet edhe |

| | |
|---|---|
| | në pagë, pjesëmarrjen e personelit në aktivitete shkencore, botime të artikujve shkencorë në Periodikë me ose jo me Faktor Impakti, apo me Bord editorial.<br>- Organizon Konferenca Shkencore, ku mund të marrin pjesë të gjithë anëtarët e stafit akademik.<br>**Kriteri 2.** Institucioni ka një bazë të dhënash të hollësishme për të gjitha programet e ofruara, si në formë elektronike, ashtu edhe në formë të shkruar. |

**Konkluzione të GVJ:** Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në bashkëbisedimin që patëm me Zyrën e Burimeve Njerëzore, konstatojmë se:

1. Institucioni, bazuar në Statutin e tij, ka miratuar një rregullore të qartë punësimi për rekrutimin e personelit të brendshëm dhe të jashtëm.
2. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit të ri, të brendshëm dhe të jashtëm, dërgohen fillimisht, sipas ligjit shqiptar, në Zyrën Rajonale të Punës, dhe me pas publikohen në faqen zyrtare të Institucionit në internet. Të gjitha kriteret bëhen publike në gjuhën shqipe dhe angleze, për t'i dhënë mundësi edhe personelit të huaj, që të bëhet pjesë e mësimdhënies në këtë Institucion.
3. Zyra e Burimeve Njerëzore, pranë këtij Institucioni, ka krijuar një bazë të dhënash, në formën e dosjeve personale për çdo pedagog të brendshëm dhe të jashtëm. Dosjet përmbajnë dokumentacionin e nevojshëm, i cili është shqyrtuar nga komisioni i ngritur për vlerësimin e tyre gjatë konkurrimit.
   **Këshillojmë** që dosjet e pedagogëve të punësuar të jenë më të plota.
   - Ato duhet të përmbajnë me hollësi të gjithë veprimtarinë e pedagogëve, jo vetëm kopje të noterizuar të diplomave dhe gradave shkencore, por edhe CV të firmosur prej tyre, si dhe kopje të botimeve dhe punime shkencore në revista, apo konferenca të ndryshme.
   - Në Cv-të e tyre duhet të jetë i shprehur qartë specialiteti që mbulojnë, si dhe përvoja që kanë në mësimdhënien e një lënde të caktuar, e cila duhet të korrespondojë me lëndën që marrin përsipër të zhvillojnë.
4. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke është përpjekur të rekrutojë një staf akademik të kualifikuar, me grada shkencore, në një përqindje relativisht të mirë. Në total, pranë këtij Departamenti punojnë: 7 pedagogë me grada shkencore dhe 6 pedagogë pa grada shkencore.
   **Këshillojmë** se duhet të synohet për më mirë.
   - Duhet të rritet numri i personelit të rekrutuar, si i brendshëm dhe i jashtëm, që ka grada shkencore ose tituj akademikë, sipas specialiteteve të lëndëve që jepen.
   - Duhet të bëhet më kujdes në çështje të raportit 70% personel i brendshëm/30% personel i jashtëm
5. Institucioni tregon seriozitetin e duhur në çështje të instruktimit, udhëheqjes dhe orientimit të mirë të studentëve. Çdo fillim viti akademik miratohen këshilltarët e studentëve sipas një rregulli të përcaktuar, ku çdo këshilltar nuk ka më shumë se 10 studentë në ngarkim.
6. Në mënyrë periodike ky Institucion harton programe te veçanta, që kanë si synim kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik dhe ndihmon me mënyra të ndryshme përparimin e tyre në profesion.

Pas kësaj analize, grupi ynë i vlerësimit konstaton se ky Departament, që mbulon këtë program studimi, i përmbush të gjitha standardet e kërkuara në pikat: III.1, III.2, III.3, III.4 dhe e miraton atë.

7. **Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitet**
**<u>Pjesa përshkrimore</u>**

**Terma reference**: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Ky Institucion gjendet në Tiranë, në një ambient prej 3945 m2, të shpërndarë ne 9 kate. Gjithashtu, Institucioni, edhe sipas dokumentacionit të dhënë, synon ngritjen e një kampusi universitar me sip. 7000 m2, nga të cilat 13.147 m2 do të jenë sipërfaqe e mbyllur. Sip. E klasave dhe auditorëve do të jenë 3258 m2, dhomat teknike 530 m2, zyrat e personelit dhe sallat e mbledhjeve 4080m2.

**<u>Tregues të matshëm:</u>**

☑ Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Kjo degë ka në funksionim:

- 3 salla leksionesh me sip. 123.2 m2
- 2 klasa për seminare me sip. 194.4 m2
- 1 laborator me sip. 44.6 m2
- 1 sallë biblioteke me sip. 189 m2
- 1 salle konferencash me sip. 200 m2 dhe me kapacitet 190 persona
- 1 laborator kompjuterik me 24 kompjuterë
- 1mjedis për fotokopje, librari etj. me sip. 15.9 m2
- 1 zyrë informacioni për studentët me sip. 33 m2
- 3 nyje hidrosanitare me sip. 7.5 m2

☑ Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Kjo degë ka në funksionim:

- 1 zyrë për dekanin/zv.dekanin me sip. 30.9 m2

- 1 zyrë për sekretarinë mësimore me sip. 25.9 m2
- 4 zyra për personelin akademik me sip. 90 m2

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardit/ kriterit |
|---|---|
| **V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI**<br>**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;<br>**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;<br>**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;<br>**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;<br>**Kriteri 5** Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. | **Kriteri 1.** Literatura që u vihen në dispozicion studentëve është e pasqyruar në silabuset e lëndëve në formën e dy rubrikave: literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse. Në një pjesë të lëndëve në literaturën bazë futen edhe leksionet e përgatitura nga lektori i lëndës.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni disponon një bibliotekë të pasur me literaturë të përzgjedhur, e cila shihet si e mjaftueshme për ta ndihmuar studentin në përfundimin me sukses të këtij programi studimor. Në sektorin e gjuhësisë dhe të letërsisë së kësaj biblioteke, studenti i kësaj dege mund të gjejë material të bollshëm për të gjitha lëndët në turqisht, shqip dhe anglisht. Koleksioni i bibliotekës përditësohet dhe pasurohet vazhdimisht.<br>**Kriteri 3.** Biblioteka disponon një numër periodikësh të caktuar, kryesisht nga Turqia dhe për t'i shërbyer më mirë nevojave të stafit akademik dhe studentëve, është mundësuar abonimi në bibliotekën online.<br>**Kriteri 4.** Departamenti, në bashkëpunim me hartuesit e programit mësimor, periodikisht përcakton dhe planifikon titujt e nevojshëm, të cilat ia paraqet rektoratit.<br>**Kriteri 5.** Biblioteka i ka oraret e shërbimit të përcaktuara dhe të shpallura në ambientet e universitetit. Për lehtësinë e studentëve ato janë në përputhje me oraret e programit të studimit.<br>Në rastet e mbingarkesës edhe ambiente të tjera, si psh. Salla e kompjuterave, kthehej në sallë leximi e studimi. |
| **Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise | **Kriteri 1.** Nga inspektimirezulton se Institucioni ka në dispozicion një sasi të |

| | |
|---|---|
| të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;<br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;<br>**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;<br>**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.<br>**Kriteri 5** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.<br>**Kriteri 6** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale. | mjaftueshme ambientesh, si: klasa, laboratorë, zyra etj, të pajisura më së miri me mjetet elektronike të teknologjisë së informacionit, në ndihmë të realizimit me sukses të procesit mësimor.<br>**Kriteri 2.** Klasat janë të pajisura me dërrasa interaktive, projektorë, kompjuterë, ndriçim të mjaftueshëm, si dhe janë të mobiluara ne mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.<br>**Kriteri 3.** Në Institucion funksionon Laboratori i gjuhëve të huaja, i pajisur më së miri me mjetet e nevojshme për funksionimin e tij.<br>**Kriteri 4.** Në Institucion, edhe në funksion të Degës së Gjuhës dhe të Letërsisë turke, funksionon Laboratori i gjuhëve të huaja, për mësimin e gjuhës turke, shqipe për të huaj, si dhe për mësimin e gjuhës angleze.<br>**Kriteri 5.** Institucioni disponon kompjuterë në laboratorin e gjuhëve të huaja, të pajisur me programe profesionale për gjuhësinë.<br>**Kriteri 6.** Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke i kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Ai ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat në Shqipëri dhe në Turqi, si me:<br>• Today’s Zaman, Stamboll, Turqi<br>• STV, Stamboll, Turqi<br>• Qendra e kurseve të gjuhëve të huaja Meridian, Tiranë, Shqipëri<br>• Albtelekom, Sh. a, Tiranë, Shqipëri<br>• Univers Alb. Sh.a (American Hospital), Tiranë, Shqipëri.<br>Gjithashtu, Institucioni ofron edhe mundësi praktikash profesionale brenda tij, në zyrën e marrëdhënieve me publikun, median, bibliotekë etj. |
| **<u>Konkluzione të GVJ:</u>** Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në bashkëbisedimin që patëm me anëtarë të Departamentit, si dhe në vizitën e bërë në ambientet e universitetit dhe në Bibliotekë, konstatojmë se:<br>• Literatura që u vihen në dispozicion studentëve është e pasqyruar në silabuset e lëndëve në formën e dy rubrikave: literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse.<br>**Këshillojmë** që duhet të punohet më mirë për përzgjedhjen e teksteve bazë mësimore.<br>- Do të ishte mirë, që studentët, për të gjitha lëndët, të kishin një tekst universitar. Sidomos kur bëhet fjalë për lëndë si: gjuha shqipe për shqiptarë dhe gjuha shqipe për të huaj, për të cilat ka botime të aprovuara dhe provuara shkencërisht, përzgjedhja duhet të jetë më e kujdesshme.<br>- Meqenëse, dega synon t’i pajisë studentët edhe me profesionin e përkthyesit, duhet | |

bërë më shumë kujdes në përzgjedhjen e një larmie më të madhe tekstesh për realizimin e lëndëve të përkthimit.

- Institucioni disponon një bibliotekë të pasur me literaturë të përzgjedhur, e cila shihet si e mjaftueshme për ta ndihmuar studentin në përfundimin me sukses të këtij programi studimor. Koleksioni i bibliotekës përditësohet dhe pasurohet vazhdimisht.
  **Këshillojmë** që :
  - Duhet të punohet më shumë për abonimin e rregullt në periodikë gjuhësorë vendas dhe të huaj, në mënyrë që, si personeli akademik, ashtu edhe studentët, të jenë më pranë me zhvillimet e fundit të shkencave gjuhësore.
  - Lista e titujve që disponon biblioteka të shpallet në web-in e Universitetit.

- Biblioteka i ka oraret e shërbimit të përcaktuara dhe të shpallura në ambientet e universitetit. Për lehtësinë e studentëve ato janë në përputhje me oraret e programit të studimit.
- Nga inspektimirezulton se Institucioni ka në dispozicion një sasi të mjaftueshme ambientesh, si: klasa, laboratorë, zyra etj, të pajisura më së miri me mjetet elektronike të teknologjisë së informacionit, në ndihmë të realizimit me sukses të procesit mësimor.
- Funksionimi i Laboratorit të gjuhëve të huaja, si dhe mjetet teknologjike moderne janë një përparësi për këtë Universitet.
- Gjithashtu mundësitë që ofron ky universitet për realizimin e praktikave mësimore, brenda dhe jashtë vendit, janë një përparësi tjetër. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat në Shqipëri dhe në Turqi, si me:
  - Today's Zaman, Stamboll, Turqi
  - STV, Stamboll, Turqi
  - Qendra e kurseve të gjuhëve të huaja Meridian, Tiranë, Shqipëri
  - Albtelekom, Sh. a, Tiranë, Shqipëri
  - Univers Alb. Sh.a (American Hospital), Tiranë, Shqipëri.
  - Gjithashtu, Institucioni ofron edhe mundësi praktikash profesionale brenda tij, në zyrën e marrëdhënieve me publikun, median, bibliotekë etj.

**Këshillojmë** se do të ishte me vlerë, si për universitetin, ashtu edhe për studentët, që në kuadrin e praktikave mësimore, të realizonin një marrëveshje bashkëpunimi edhe me Degën e Turkologjisë së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të Universitetit të Tiranës, si dega e vetme simotër e saj në Shqipëri. Pas kësaj analize, grupi ynë i vlerësimit konstaton se ky Departament, që mbulon këtë program studimi, i përmbush të gjitha standardet e kërkuara në pikat: V.1,V.2 dhe e miraton atë.

8. **Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

**<u>Pjesa përshkrimore</u>**

**Terma reference**: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Ky institucion është institucion privat jofitimprurës. Ai ka të drejtë të pranoje mbështetje financiare dhe materiale që lidhen me objektin e veprimtarisë së tij ne përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Në bazë të dispozitave të ligjit nr. 10056, datë 22.01.2009 "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjella", ky Institucion është i përjashtuar nga pagimi i taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera ndaj shtetit.

Shpenzimet operative për vitin akademik 2011-2012 ishin 606.012 euro.

Institucioni mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

**<u>Tregues të matshëm:</u>**

☑ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**

- Grantet për kërkim (rezultojnë 0)
- Konsulencat, shërbimet (rezultojnë 0)
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit (rezultojnë 14,811,159)
- Sponsorizimet (rezultojnë 0)
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) (rezultojnë0)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj (rezultojnë 50,589,655)
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) (rezultojnë 0)

Të gjitha këto të dhëna janë për vitin e parë

☑ Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Tarifat gjatë shkollimit rezultojnë të jenë: 14.811.159

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardit/ kriterit |
|---|---|
| **VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR**<br>**Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;<br>**Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;<br>**Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare | **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar, tre muajt e parë të vitit, për vitin paraardhës.Në këtë raport përfshihet një pasqyrë e hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare.<br>**Kriteri 2.** Meqenëse, ky Institucion, është në fillimet e veprimtarisë së tij, raporti i parë financiar do të publikohet dhe dokumentohet, sipas parashikimeve të institucionit në mars 2013, pra gjatë këtij |

| | |
|---|---|
| dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | muaji.<br>**Kriteri 3.** Ky institucion gëzon statusin e Institucionit të arsimit të Lartë jofitimprurës. Deri tani ka dëshmuar se ka qëndrueshmëri financiare gjatë zhvillimit të programit të studimit, si dhe kapacitete të mjaftueshme financiare për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. |
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;<br>**Kriteri 2** Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj.;<br>**Kriteri 3** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë. | **Kriteri 1.** Meqenëse Institucioni është në fillimet e tij, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm do të bëhet brenda këtij tremujori.<br>**Kriteri 2.** Në raportin e auditimit, që do të hartohet më pas, është parashikuar që do të paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative etj.<br>**Kriteri 3.** Raporti i parashikuar i auditit për t'u hartuar nuk përmban pasqyrë të grandeve të huaja të përfituara, pasi deri tani nuk ka pasur të tilla. Nëse deri në momentin e hartimit të raportit do të ketë të tilla, ato do të zënë vend në raport. |
| <u>**Konkluzione të GVJ:**</u> Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në bashkëbisedimin që patëm me funksionarë të Institucionit konstatojmë se:<br>• Meqenëse, ky Institucion, është në fillimet e veprimtarisë së tij, raporti i parë financiar do të publikohet dhe dokumentohet, sipas parashikimeve të institucionit në mars 2013, pra gjatë këtij muaji.<br>• Ky institucion gëzon statusin e Institucionit të arsimit të Lartë jofitimprurës. Deri tani ka dëshmuar se ka qëndrueshmëri financiare gjatë zhvillimit të programit të studimit.<br>• Meqenëse Institucioni është në fillimet e tij, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm do të bëhet brenda këtij tremujori. | |

9. **Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

<u>**Pjesa përshkrimore**</u>

**Terma reference**: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në këtë Institucion, organi përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të menaxhimit dhe vlerësimit akademik e administrativ,

zhvillimit të cilësisë, planifikimit strategjik, vlerësimit institucional, vlerësimit të jashtëm, kontrollit periodik etj, është Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë. Ai ka në strukturën e tij 3 komisione autonome të miratuara nga Senati. Komisioni i brendshëm i sigurimit të cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

Organizimi, funksionimi, detyra dhe përgjegjësitë e tij janë të përcaktuara në rregulloren: "Mbi vlerësimin akademik dhe zhvillimin e cilësisë"

**<u>Tregues të matshëm:</u>**

☑ Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Tabela 4)

| | Anëtarët e NJSBC | Detyra që ka në në NJSBC | Sa kohë ka në këtë detyrë |
|---|---|---|---|
| 1 | Dr. Bayram Karci | Kryetar | 27.02.2012 |
| 2 | Ramadan Çipuri | Zv. Kryetar | 27.02.2012 |
| 3 | Prof.ass.dr. Rahim Ombashi | Anëtar | 10.10.2012 |
| 4 | Manjola Çollaku | Anëtar | 27.02.2012 |
| 5 | Arti Omeri | Anëtar | 27.02.2012 |
| 6 | Albi Koçibelli | Anëtar | 27.02.2012 |
| 7 | Nertil Bërdufi | Anëtar | 10.10.2012 |
| 8 | Enriketa Sogutlu | Anëtar | 10.10.2012 |
| 9 | Gentjan Skara | Anëtar | 27.02.2012 |

☑ Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët

  Anketimet kanë filluar të bëhen rregullisht duke nisur nga semestri i vjeshtës i vitit akademik 2011-2012. Anketat bëhen pra çdo provimi dhe kanë rubrika të veçanta për vlerësimin e punës se pedagogut si dhe për vlerësimin e lëndës. Anketat përmbajnë 32 pyetje adresuar studentëve.
- Sa studentë janë anketuar

  Janë anketuar të gjithë studentët.
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

  Janë përpunuar të gjitha anketat e bëra dhe janë nxjerrë edhe rezultatet përkatëse. Rezultatet e performancës janë shpërndarë nga rektorati për lektorët ne fjalë, si dhe për krerët e departamenteve përkatëse. Fshehtësia e informacionit ruhet në të gjitha fazat e nxjerrjes së rezultateve të shpërndarjes së korrespondencës në njësite në fjalë e te personat, si dhe në arkivimin e saj.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

  Ka pasur raste të ndryshimit të pedagogëve dhe zëvendësim me pedagogë më të kualifikuar.
- Etj

☑ Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë funksionon krejtësisht.

☑ Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Ky Institucion, gjatë vitit akademik 2011-2012, ka aplikuar për t'u certifikuar për ISO9001: 2008, ISO 14001 dhe 18001 OHSAS për sistemet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë qellim, janë caktuar 1 drejtor cilësie dhe 5 anëtarë të brendshëm, si përgjegjës për zbatimin e procesit. Këta persona janë trajnuar nga një kompani e jashtme për te gjitha aspektet kryesore të procesit.

☑ Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në përfundim të çdo viti akademik, Institucioni përgatit një raport vjetor për vetëvlerësimin, i cili i dorëzohet Këshillit të Lartë. Rezultatet e vetëvlerësimevekanëqenëpozitive.

☑ Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Bazuar në raportin vjetor për vetëvlerësim, Këshilli i Auditimit, i emëruar nga Këshilli i Lartë, kryen auditimin e brendshëm, harton përfundimet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat u përcillen për ndjekje autoriteteve drejtuese të Institucionit.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Bashkëngjitur materialit do të jenë edhe rezultatet e anketës që iu bë studentëve të këtij programi studimi. Vlerësimi rezulton të jetë pozitiv.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| **Standardet/kriteret** | **Përmbushja e standardit/ kriterit** |
|---|---|
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;<br>**Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;<br>**Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:<br><br>Të tërthorta:<br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;<br>c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj.<br><br>Të drejtpërdrejta:<br><br>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Vlerësimi me nota/pikë;<br>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;<br>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;<br>g. Etj. | **Kriteri 1.** Institucioni ka ngritur Këshillin e Vlerësimit Akademik dhe të Zhvillimit të Cilësisë, NJSBC-në, i cili në mënyrë periodike bën vlerësimin e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe administrative të Institucionit. Kompetencat e këtij Këshilli janë të parashikuara në Statut dhe në Rregulloren e Vlerësimit Akademik.<br>**Kërkesa 2.** Vlerësimi i veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe administrative përfshihet në raportin për vetëvlerësim institucional.<br>**Kërkesa 3.** Pas çdo sondazhi bëhet rivlerësimi i punës së pedagogut, si dhe rivlerësimi i brendisë së lëndës. Bazuar në këto rivlerësime, departamenti harton ndryshimet e nevojshme, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit të Fakultetit, i cili me pas i dërgon për miratim në Senat. Nga takimi me anëtarët e NJSBC-së, rezulton se përfundimet e sondazheve, ruhen në njësitë drejtuese të Institucionit, por nuk publikohen.<br>**Kërkesa 4.** Për kryerjen e vlerësimit Institucioni bën sondazhe dhe anketime të studentëve para çdo provimi final. Këto anketime synojnë vlerësimin e programeve mësimore të lëndëve, sa të përshtatshme janë ato, sa e vlefshme është kurrikula, si dhe vlerësimin e pedagogëve. Nga takimi me anëtarët e NJSBC-së, rezulton se ka pasur raste, kur bazuar në anketimet e bëra janë ndryshuar pedagogë dhe janë bërë ndërhyrje në programe lëndësh.<br>Veç anketimeve përdoren edhe inspektime për kontrollin e cilësisë. |
| **VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË**<br>**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;<br>**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të | **Kriteri 1.** Dosja e aplikimit për vlerësim institucional nuk është dorëzuar para aplikimit për akreditimin e programeve të studimit, por janë dorëzuar të dyja në të njëjtën kohë për akreditim pranë APAAL-së.<br>**Kriteri 2.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Ai ka |

| | |
|---|---|
| veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;<br>**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;<br>**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;<br>**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. | ngritur Bordin e Vlerësimit Akademik dhe të Zhvillimit të Cilësisë, i cili funksionon sipas Rregullores për Vlerësimin Akademik dhe Zhvillimin e Cilësisë.<br>**Kriteri 3.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë për vlerësimin e efektshmërisë së programeve dhe mësimdhënies së pedagogëve. Vlerësimi është periodik, para çdo provimi final dhe zhvillohet si për pedagogët e brendshëm, ashtu edhe për pedagogët e jashtëm.<br>**Kriteri 4.** Bazuar në vlerësimet e kryera, propozimet për ndryshimin e programeve mësimore bëhen duke mbajtur parasysh parimin hierarkik vertikal, pra propozohen nga Departamenti, i cili propozimet ia përcjell Fakultetit, për të përfunduar në Rektorat e për t'u shqyrtuar në Senat. Procesi i ndryshimit të Kurrikulave, bëhet nën koordinimin e Zyrës së menaxhimit të Kurrikulave.<br>**Kriteri 5.** Institucioni synon ndërgjegjësimin e stafit akademik, si dhe të studentëve, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në programet e studimet që u ofrohen. Për këtë, Institucioni ka hartuar dy guida: Guidën Studentore dhe Guidën e Stafit, në të cilat shprehet qartë rëndësia e cilësisë së programeve të studimit, si dhe rëndësia e cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu janë organizuar disa trajnime, si dhe një Konferencë Ndërkombëtare me temë bosht: "Sfidat dhe zhvillimi i cilësisë në arsimin e lartë".<br>**Kriteri 6.** Institucioni ka hartuar një plan strategjik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, i cili është i publikuar në planin strategjik të tij. |

**<u>Konkluzione të GVJ:</u>** Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në takimin që patëm me anëtarët e NJSBC-së konstatojmë se:

- Institucioni ka ngritur Këshillin e Vlerësimit Akademik dhe të Zhvillimit të Cilësisë, NJSBC-në, i cili në mënyrë periodike bën vlerësimin e veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe administrative të Institucionit.
- Për kryerjen e vlerësimit Institucioni bën sondazhe dhe anketime të studentëve para çdo provimi final. Këto anketime synojnë vlerësimin e programeve mësimore të lëndëve, sa të përshtatshme janë ato, sa e vlefshme është kurrikula, si dhe vlerësimin e pedagogëve.
- Pas çdo sondazhi bëhet rivlerësimi i punës së pedagogut, si dhe rivlerësimi i brendisë së lëndës. Bazuar në këto rivlerësime, departamenti harton ndryshimet e nevojshme, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit të Fakultetit, i cili me pas i dërgon për miratim në Senat. Nga

takimi me anëtarët e NJSBC-së, rezulton se përfundimet e sondazheve, ruhen në njësitë drejtuese të Institucionit, por nuk publikohen.
**Këshillojmë** që të kryhen anketime edhe pas provimit për mënyrën e vlerësimit të studentëve.

Pas kësaj analize, grupi ynë i vlerësimit konstaton se njësia e NJSBC-së funksionon plotësisht dhe i përmbush të gjitha standardet e kërkuara.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 10. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Objektivi i këtij programi studimor është përgatitja e kuadrove të kualifikuar në fushën e gjuhës dhe letërsisë turke. Departamenti i gjuhës dhe letërsisë turke synon t'u mësojë studentëve konceptet themelore të gjuhës dhe mënyrën e qasjes së informatave dhe njohurive te fituara, të pajisura me teknika hulumtuese moderne, për të trajnuar nxënësit në kërkimet shkencore që mund të konsiderohen si multi-dimensionale.

#### Tregues të matshëm:

☑ Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

☑ Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- ➢ 1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor
- ➢ 1 Semestër ka 16 javë mësimore në auditor

☑ Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

Në tabelën e mëposhtme jepet ndarja e ECTS, sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë.

☑ Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara

Nuk ka ndryshime në programet mësimore

(Tabela 5)

| Lëndë/Module | | Semestri | ECTS | **Orë mësimore** | | | | | | | | | | | | | | | Provime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Leksione** | | | **Seminare** | | | **Laborator** | | | **Praktikë** | | | Orë në auditor | Punë e Pavarur | Gjithsej | |
| | | | | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | P. e Pavarur | ECTS | Në auditor | Punë e Pavarur | | | | |
| 1 | Gramatika e gjuhës turke I | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **24** | 125 |
| 2 | Osmanisht I | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **21** | 125 |
| 3 | Teoritë dhe njohuritë e letërsise turke I | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **20** | 125 |
| 4 | Shkrim akademik | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **20** | 125 |
| 5 | Gjuhë shqipe | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **29** | 125 |
| 6 | Anglisht I | I | **5** | **3** | 48 | 27 | **2** | 32 | 18 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 80 | 45 | **8** | 125 |
| 7 | Gramatika e gjuhës turke II | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **20** | 125 |
| 8 | Osmanisht 2 | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **20** | 125 |
| 9 | Teoritë dhe njohuritë e letërsise turke II | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **24** | 125 |
| 10 | Analizë teksti | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **20** | 125 |
| 11 | Gjuhë shqipe II | I | **5** | **5** | 48 | 77 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 48 | 77 | **26** | 125 |
| 12 | Anglisht II | I | **5** | **3** | 48 | 27 | **2** | 32 | 18 | **0** | 0 | 0 | **0** | 0 | 0 | 80 | 45 | **9** | 125 |
| Ndryshime në Total | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

☑ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

1 ECTS= 25 orë mësimore/ 1 orë mësimore= 60 ‘

☑ Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 6)

| Lënda /Moduli | | Pedagogu/ët përgjegjës | Titulli/grada kualifikimi | Departamenti | Statusi PAE apo PAK |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Osmanisht, | Adem Balaban | Dr. | Gjuhë dhe | PAE |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Gramatikë e gjuhës turke, Historia e gjuhës turke, Studime fjalori dhe fjalorët në gjuhën turke, Përdorimi i turqishtes në Ballkan | | | letërsi turke | |
| 2. | Paleografia osmane, Historia e kulturës turke, | CeyhunVedat Uygur | Prof.dr. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAE |
| 3. | Letërsia moderne turke, Letërsia dhe lëvizjet letrare në Evropën perëndimore | Sezayi Coskun | Prof.asc.dr. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAE |
| 4 | Teoritë dhe njohuritë e letërsisë turke I, Teorite dhe njohuritë e letërsisë turke II, Mësimi i turqishtes për të huaj, Shkrimtarët dhe poetët shqiptarë që shkruajnë në turqisht, Letërsia për fëmijë, Letërsia klasike turke II, Letërsia klasike turke I, | Bunyamin Çaglayan | Dr. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAE |
| 5 | Analizë teksti | Gulay Yurt | Ma. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAE |
| 6 | - | Hakan Kacar | Ma. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAE |
| 7 | Letërsia popullore turke | Huseyin Yilmaz | Ma. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAE |
| 8 | - | Genciana Abazi Egro | Prof.asc.dr. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAK |
| 9 | Hyrje në gjuhësi, Studime përkthimi anglisht-turqisht, turqisht-anglisht, Teoritë e përkthimit | Adriatik Derjaj | Dr. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAK |
| 10 | Morfologji e gjuhës turke | Spartak Kadiu | Ma. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAK |
| 11 | - | Ermal Nurja | Ma. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAK |
| 12 | - | Dritan Egro | Prof.asc.dr. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAK |
| 13 | - | Omer Yurekten | Ma. | Gjuhë dhe | PAK |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | letërsi turke | |
| 14 | | Salih Okumus | Dr. | Gjuhë dhe letërsi turke | Mik |
| 15 | Gjuhë shqipe | Etleva Gogu | Ma. | Gjuhë dhe letërsi turke | PAK |
| 16 | Historia e shek. 20 në Ballkan | Skënder Brucaj | doktorant | Gjuhë dhe letërsi turke | PAE |

☑ Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Të gjitha Syllabus-et e lëndëve të këtij programi kanë të njëjtin format dhe janë të mirë organizuar, me të gjitha elementet përbërëse të tyre. Aty përfshihen:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

☑ Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardit/ kriterit |
|---|---|
| **I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA**<br>**Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);<br>**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | **Kriteri 1.** Ky program studimor organizohet në module dhe vlerësohet në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga MASH.<br>**Kriteri 2.** Studenti që ndjek këtë program studimi, grumbullon gjithsej 60 kredite. |
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.** | |
| **Kriteri 1** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;<br>**Kriteri 3** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;<br>**Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj. | **Kriteri 1.** Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, si dhe Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë turke, shpall në web-in e Universitetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve Bachelor. Ky informacion mund të tërhiqet edhe pranë sekretarisë mësimore, si dhe pranë sekretarisë së departamentit.<br>**Kriteri 2.** Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, si dhe Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë turke, shpall në web-in e Universitetit gjithë informacionin e nevojshëm për lëndët me zgjedhje dhe ato të detyrueshme për çdo semestër.<br>**Kriteri 3**. Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, si dhe Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë turke, shpall në web-in e Universitetit gjithë informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët ne auditor, për frekuentimin etj.<br>**Kriteri 4.** Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, si dhe Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë turke, shpall në web-in e Universitetit gjithë informacionin e nevojshëm për silabuset e çdo lënde. Studentët pajisen me to nga çdo lektor në fillim të semestrit. Gjithashtu ky informacion mund të tërhiqet edhe nga sekretaria mësimore, si dhe nga sekretaria e |

| | |
|---|---|
| | departamentit. |

**Konkluzionet e GVJ:** Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në takimet që patëm me anëtarët e Departamentit konstatojmë se:

- Ky program studimor organizohet në module dhe vlerësohet në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai zhvillohet në përputhje me programin e licensuar nga MASH. Studenti që ndjek këtë program studimi, grumbullon gjithsej 60 kredite.
  - Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, si dhe Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë turke, për të qenë sa më transparent me studentët, shpall në web-in e Universitetit gjithë informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor, për frekuentimin, për lëndët me zgjedhje dhe ato me detyrim, për silabuset e secilës lëndë etj. Këto informacione mund të tërhiqen edhe pranë Sekretarisë mësimore, si dhe pranë Sekretarisë së Departamentit.

  **Këshillojmë se** duhet bërë më kujdes në hartimin e një programi mësimor më të dobishëm për studentët:
    - Meqenëse një nga synimet e degës është përgatitja e përkthyesve, duhet të shtohen module të lëndës së gjuhës shqipe, që kanë të bëjnë me Gramatikën dhe Drejtshkrimin e saj (si për studentët shqiptarë, ashtu edhe për studentët me kombësi të huaj)
    - Meqenëse përbërja e studentëve është heterogjene dhe një nga synimet e degës është përgatitja e mësuesve të ardhshëm të gjuhës turke, do të ishte e volitshme që studentët të pajiseshin me njohuri edhe mbi didaktikën dhe metodikën e mësimdhënies së gjuhës turke për shqiptarët e për të huajt.
    - Duhet bërë kujdes në shpërndarjen e lëndëve, pasi nga vëzhgimet dhe tabelat na rezultojnë pedagogë pa lëndë dhe pedagogë me mbi 2-3 lëndë.

Pas kësaj analize, grupi ynë i vlerësimit konstaton se, Programet e studimit të ciklit të parë janë të detajuar, informuese dhe të hapura për të gjithë. Programi Bachelor në Degën Gjuhë dhe Letërsi Turke, i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara.

## 11. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference**: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Institucioni ka hartuar një Rregullore të Studimeve Bachelor ku sqarohen hollësisht të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesën mësimore, kontrollin e njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies, aktivizimin e studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

### Tregues të matshëm:

☑ Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratorë
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Sipas programit mësimor, procesi mësimor i këtij programi studimi përbëhet kryesisht nga: leksione në auditor, seminare, ushtrime, projekte, punë në laborator dhe atelie, praktika profesionale, punim ne terren, punim diplome etj. Të gjithë këto elementë shpërndahen në ngarkesën mësimore javore e cila hartohet sipas udhëzimeve të marra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 9741, datë 21.05.2077, i ndryshuar si dhe nga udhëzimet respektive të MASH.
Sipas të dhënave, i gjithë procesi mësimor i këtij programi studimi realizohet nëpërmjet:

- Leksione: 1728 orëmësimore
- Seminare: 192 orëmësimore

Ngarkesa e përgjithshme mësimore për këtë program është si më poshtë vijon:

- Për leksionet 1728 orë në auditor dhe 2472 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 192 orë në auditor dhe 108 orë punë e pavarur e studentit
- Për Laboratoret 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 72 orë në auditor dhe 742 orë punë e pavarur e studentit

☑ Format e kontrollit të njohurive

Institucioni përcakton format e kontrollit, duke lënë në dorën e pedagogut peshën e tyre. Ato shënohen në syllabus dhe synohet që nota përfundimtare e çdo lënde të jetë e përbërë nga disa zëra. Forma e kontrollit dhe formula e vlerësimit të studentëve, për çdo lëndë, prezantohet në Plan-programin e secilës lëndë. Në fillim të semestrit pedagogët ua prezantojnë studentëve këtë formulë vlerësimi. Provimi përfundimtar zë përqindjen më te madhe të vlerësimit.

Kontrolli i njohurive bëhet në disa forma:

- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive: 10%
- Plotësimi i detyrave (laboratorike, detyrë kursi, etj) 10%
- Testimet gjatë vitit 20 %
- Provimi përfundimtar 60%

Për efekt të objektivitetit të vlerësimit, forma e kontrollit të lëndëve bëhet me shkrim dhe e sekretuar. Fletët e provimit ruhen në një zarf të mbyllur për 5 vjet dhe arkivohen. Këtë proces e pamë edhe gjatë takimeve me personelin e këtij Departamenti.

☑ Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj
Studentët e këtij programi studimor marrin pjesë në aktivitetet e njësisë. Deri tani janë aktivizuar 15 studentë në projektet shkencore të departamentit.

## 12. Studentët

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

**Tregues të matshëm:**

☑ Procedurat e pranimit të studentëve

Ky Institucion ka të përcaktuar kushtet për pranimin e studentëve vendas dhe të huaj, si dhe procedurat e përzgjedhjes së tyre. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të fakultetit për një mësim normal dhe brenda standardeve. Synohet të pranohen kryesisht studentë me mesatare mbi 8. Përzgjedhja e kandidatëve që nuk e gëzojnë këtë mesatare bëhet nga Komiteti Shkencor, i cili përbëhet nga:

- Drejtori i Zyrës së Përzgjedhjes dhe Pranimit
- Përgjegjësi i departamentit
- Dekani i studentëve
- Kancelari

☑ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Sipas të dhënave studentët kanë hyrë mesatarisht me mesataren 6.2 nga shkolla e mesme, dhe për vitin akademik kanë arritur ne rezultatet e tyre mesataren 6.74

☑ Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)

Gjatë vitit akademik 2011-2012 janë regjistruar 28 studentë

Gjatë vitit akademik 2012-2013 janë regjistruar 33 studentë

☑ Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)

Ende nuk studentë të diplomuar.

☑ Nota Mesatare

Nota mesatare për vitin akademik 2011-2012 rezulton 6.74

Nota mesatare për vitin akademik 2012-2013 rezulton 6.87

☑ Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Lejohet transferimi i studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta vendase ose të huaja, vetëm pasi bëhet barasvlerësimi i provimeve, sipas programeve mësimore.

☑ Të dhëna për punësimin e studentëve

Nuk ka

☑ Numri total të diplomuarve

Nuk ka

☑ Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Nuk ka

☑ Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Nuk ka

☑ etj

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardit/ kriterit |
|---|---|
| **IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE**<br>**Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.** | |
| **Kriteri 1** Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.<br>**Kriteri 2** Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. | **Kriteri 1**. Nga takimi që patëm në Sekretarinë mësimore, si dhe nga vëzhgimi i dosjeve të pranimit të studentëve, rezulton se pranimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Regjistrimi, si për shtetasit shqiptarë, ashtu edhe për ata të huaj bëhet pasi ata vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme. Për përzgjedhjen e kandidatëve ngrihet një Komitet Shkencor.<br>**Kriteri 2.** Ky Institucion, ka vënë si |

| | |
|---|---|
| | kriter bazë për pranimin e kandidatëve, mesataren mbi 8 (tetë) të shkollës së mesme. Kjo kërkesë është e specifikuar në nenin 5 të Rregullores së studimeve Bachelor. Kandidatët që nuk e plotësojnë këtë kusht i nënshtrohen një provimi pranimi, si dhe një interviste me Përgjegjësin e Departamentit. |
| **Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.** | |
| **Kriteri 1** Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;<br>**Kriteri 2** Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;<br>**Kriteri 3** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;<br>**Kriteri 4** Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi. | **Kriteri 1.** Në fillim të vitit akademik, Institucioni organizon Javën e Orientimit, shpërndan Guidën e studentit, si dhe publikon në faqen zyrtare të tij, në mënyrë të detajuar programin e studimit. Në këtë mënyrë studentët informohen hollësisht për programin e studimit.<br>**Kriteri 2.** Duke filluar nga semestri i vjeshtës së vitit akademik 2011-2012, janë zhvilluar anketa vlerësimi para çdo provimi final, për të gjitha lëndët dhe për të gjithë pedagogët e jashtëm dhe të brendshëm. Studentëve, në këtë mënyrë, u jepet mundësia të japin mendimin e tyre në lidhje me përmbajtjen e programeve lëndore, si dhe në lidhje me cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve. Mendimi i tyre ka ndikuar në rinovimin e kontratave të pedagogëve, si dhe në përmirësimin e programeve lëndore.<br>**Kriteri 3.** Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës në disa mënyra:<br>• nëpërmjet Dekanit të Studentëve<br>• nëpërmjet personit përgjegjës për këshillimin e karrierës.<br>• nëpërmjet këshilltarit akademik, i cili ka në kujdestari një grup studentësh, të cilët i ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore.<br>**Kriteri 4.** Studentët e kësaj dege, nëpërmjet këshillimit të karrierës, seminareve profesionale dhe leksioneve të hapura informohen hollësisht mbi mundësitë e punësimit dhe tregun e punës pas përfundimit të këtij programi mësimor. |

| Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë. | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;<br>**Kriteri 2** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademiknë të cilin zhvillohet programi i studimeve;<br>**Kriteri 3** Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. | **Kriteri 1**. Ky Institucion ende nuk ka të diplomuar.Për këtë arsye nuk ka një statistikë të tillë si ajo që kërkohet në këtë kriter. Është menduar që së shpejti të planifikohet Zyra e Alumnit, pranë Dekanatit të studentëve, e cila do të kryejë funksionin që kërkon ky kriter.<br>**Kriteri 2.** Gjatë takimit në Sekretarinë Mësimore vumë re se Institucioni ka statistika të sakta për numrin e studentëve të regjistruar në programin e ciklit të parë të studimeve, ka statistika për largimet para përfundimit të programit, si dhe për mospërfundimin me sukses të vitit akademik.<br>**Kriteri 3.** Provimet ruhen për 5 vjet dhe së bashku me të edhe elementet që kanë ndikuar në vlerësimin e studentit. Proces verbalet ruhen të mbyllura në zarf në sekretarinë mësimore. Këto dokumente kalojnë nga sekretaria e Departamentit në Sekretarinë Mësimore, e cila i arkivon ato. Arkiva e këtij tipi menaxhohet nga sekretaria mësimore. |
| **Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;<br>**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë. | **Kriteri 1.** Ky Institucion u ofron studentëve këshillim karriere. Për këtë funksionon Komiteti për Planifikimin e Karrierës, në varësi të Dekanit të studentëve. Gjithashtu, vetë Departamenti ka emëruar përfaqësuesin e tij për të ndjekur përparimin e studentëve, si dhe ka emëruar një këshilltar akademik, të miratuar nga Senati.<br>**Kriteri 2**. Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë Turke nëpërmjet marrëveshjeve të krijuara me institucione, brenda dhe jashtë vendit, i ndihmon studentët te orientohen mirë dhe të përzgjedhin si duhet institucionin ku do të zhvillojnë praktikën profesionale. Ky Departament dërgon kërkesa të veçanta në institucionet me të cilat ka marrëveshje për praktikën profesionale. |

**Konkluzionet e GVJ** Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në takimet që patëm me anëtarët e Departamentit, si dhe Sekretarinë e Mësimore, konstatojmë se:

- Pranimi i kandidatëve për studentë bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Regjistrimi, si për shtetasit shqiptarë, ashtu edhe për ata të huaj bëhet pasi ata vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme.
  **Këshillojmë** që procesi i njohjes së Diplomave të shkollës së mesme për studentët e huaj, duhet t'i paraprijë procesit të regjistrimit në Universitet.
- Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.
- Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit dhe angazhon personeli e tij për këshillimin dhe përkujdesjen ndaj studentëve.
- Institucioni, nëpërmjet organizmave të saj, si Sekretaria e Departamentit dhe Sekretaria Mësimore, ka statistika të sakta për numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi, për të çregjistruarit, si dhe për studentët që nuk e përfundojnë me sukses vitin akademik.
- Institucioni, nëpërmjet organizmave të saj, si Sekretaria e Departamentit dhe Sekretaria Mësimore, ka dokumentacion të saktë dhe të arkivuar të proces verbaleve të provimeve dhe mënyrës së vlerësimit të studentëve.

Pas kësaj analize, grupi ynë i vlerësimit konstaton se nëpërmjet këtij organizimi Institucioni mbron të drejtat e studentëve dhe i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara.

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 13. Kërkimi shkencor

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Ky Institucion është i orientuar drejt kërkimit shkencor. Ai inkurajon gjithë stafin akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare. Institucioni ka hartuar një Rregullore për Nxitjen e Publikimeve Shkencore, mbi bazën e së cilës, çdo përfundim viti akademik, një komision i posaçëm bën vlerësimin e publikimeve shkencore të botuara nga stafi akademik. Bazuar në këtë vlerësim, Këshilli Administrativ vendos masën e shpërblimit.

**Tregues të matshëm:**

- ☑ Të dhëna për kërkimin shkencor
  Stafi i këtij programi ka botuar artikuj shkencore dhe ka marrë pjesë në konferenca shkencore të ndryshme.
- ☑ Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Rezultojnë 29 botime nga stafi i këtij departamenti

- ☑ Numri i projekteve kërkimore të fituara

  Nuk ka projekte të fituara.

- ☑ Numri i projekteve të zbatuara

  Nuk ka projekte të zbatuara.

- ☑ Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

  Janë realizuar 6 aktivitete shkencore.

- ☑ Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

  Në aktivitete kanë marrë pjesë 230 vetë.

- ☑ Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

  Numri i kërkimeve në procesin mësimor rezulton gjithsej. 26

- ☑ Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

  Numri i studentëve të përfshirë në kërkim shkencor rezulton të jetë: 24

- ☑ Numri i Çmimeve Kombëtare

  Nuk ka Çmime Kombëtare

- ☑ Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

## 14. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Ky Institucion ka ngritur Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, e cila ka si detyrë të zgjerojë dhe përforcojë marrëdhëniet e këtij Institucioni me Institucione te tjera vendase dhe të huaja, në rajon e më gjerë. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi janë realizuar këmbime stafi dhe Konferenca të përbashkëta.

**Tregues të matshëm:**

- ☑ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
  - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare

Rezulton që të mos ketë pjesëmarrje partneriteti në projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare

- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj

  Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorëve të huaj rezulton të jetë: 23

- Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit

  Nuk ka

- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL

  Nuk ka

- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor

  Nuk ka

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

  Gjithsej: 3

☑ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale

  ☑ U. Pamukkale, Denizli, Turqi
  ☑ U. Istanbul Yildiz Teknik, Stamboll, Turqi
  ☑ U. Suleyman Sah, Stamboll, Turqi
  ☑ U. Fatih, Stamboll, Turqi
  ☑ U. Epoka, Tiranë, Shqipëri
  ☑ U. Ndërkombëtar i Burçit, Sarajevë, Bosnjë
  ☑ U. Gediz, Izmir, Turqi
  ☑ U. 19 Mayiz, samsun, Turqi

- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

  ☑ World Media, Frankfurt, Gjermani.
  ☑ Today's Zaman, Stamboll, Turqi
  ☑ STV, Stamboll,Turqi
  ☑ Qendra e kurseve Meridian, Tiranë, Shqipëri
  ☑ Albtelekom Sh.a, Tiranë, Shqipëri
  ☑ Univers Alb. Sh.a (American Hospital), Tiranë, Shqipëri

☑ Dokumentacioni përkatës

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardit/ kriterit |
|---|---|
| **VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME**<br>**Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;<br>**Kriteri 2** Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. | **Kriteri 1.** Ky Institucion, gjatë aktivitetit të tij i kushton rëndësibashkëpunimit të personelit brenda institucionit. Kjo realizohet nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve dhe eksperiencave, gjë që reflektohet në procedurën që ndiqet për hartimin e kurrikulës e programeve mësimore. Pedagogët diskutojnë dhe çdo gjë ia propozojnë Këshillit të Departamentit, i cili pasi merr miratimin e Këshillit të Fakultetit, e dërgon propozimin për miratim në senatin akademik. Përbërja heterogjene (nga vende të ndryshme) e stafit akademik është një risi tjetër që siguron shkëmbime përvojash të ndryshme dhe të nevojshme.<br>**Kriteri 2.** Institucioni ka një Rregullore të Organizimit Administrativ, e cila mundëson marrjen e përgjegjësive përkatëse për çdo individ, si dhe rregullon marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes tyre. Bazuar në këtë Rregullore bëhet ndarja e detyrave dhe vlerësimi i vazhdueshëm i punës së personelit. |
| **Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;<br>**Kriteri 2** Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;<br>**Kriteri 3** Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;<br>**Kriteri 4** Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | **Kriteri 1.** KyInstitucion, për realizimin me sukses të programit studimor të kësaj dege, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me:<br>**Universitete të huaja:**<br>- U. Pamukkale, Denizli, Turqi<br>- U. Istanbul Yildiz Teknik, Stamboll, Turqi<br>- U. Suleyman Sah, Stamboll, Turqi<br>- U. Fatih, Stamboll, Turqi<br>- U. Epoka, Tiranë, Shqipëri<br>- U. Ndërkombëtar i Burçit, Sarajevë, Bosnjë<br>- U. Gediz, Izmir, Turqi |

| | |
|---|---|
| | - U. 19 Mayiz, samsun, Turqi<br><br>**Aktorë biznesi:**<br>- World Media, Frankfurt, Gjermani.<br>- Today's Zaman, Stamboll, Turqi<br>- STV, Stamboll,Turqi<br>- Qendra e kurseve Meridian, Tiranë, Shqipëri<br>- Albtelekom Sh.a, Tiranë, Shqipëri<br>- Univers Alb. Sh.a (American Hospital), Tiranë, Shqipëri<br><br>Të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit janë firmosur nga të dy palët dhe rezultojnë të jenë aktive<br>**Kriteri 2.** Ky Departament u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale, të cilat janë shumë të rëndësishme për të ardhmen e studentëve në profesion. Për këtë, Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me sektorin privat në Shqipëri, Turqi dhe Gjermani.<br>- Today's Zaman, Stamboll, Turqi<br>- STV, Stamboll,Turqi<br>- Qendra e kurseve Meridian, Tiranë, Shqipëri<br>- Albtelekom Sh.a, Tiranë, Shqipëri<br>- Univers Alb. Sh.a (American Hospital), Tiranë, Shqipëri<br>**Kriteri 3.** Ky institucion, nëpërmjet Qendrës së Edukimit të Vazhduar dhe të Formimit Profesional, nxit frymën e formimit të vazhdueshëm. Ai ofron një varg metodash dhe mundësish që synojnë zhvillimin individual dhe mosshkëputjen nga mjedisi arsimor. Qendra e Edukimit të Vazhduar vepron sipas një Rregulloreje të mirëpërcaktuar. Ajo ka kryer disa programe, si:<br>- Trajnimi i stafit të Institucionit për vendosjen e standardeve ISO<br>- Komunikimi i brendshëm institucional<br>- Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë, etj.<br>**Kriteri 4.** Ky Institucion nuk merr shërbime nga palë të treta për realizimin e programeve të studimit. |

**Konkluzionet e GVJ:** Pas analizës që bëmë si Grup i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar edhe në takimet që patëm me përfaqësues të Institucionit, konstatojmë se:

- Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet. Këtë e realizon përmes funksionimit të një Rregulloreje të Organizimit Administrativ, e cila mundëson marrjen e përgjegjësive përkatëse për çdo individ, si dhe rregullon marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes tyre. Bazuar në këtë Rregullore bëhet ndarja e detyrave dhe vlerësimi i vazhdueshëm i punës së personelit.
- Përbërja heterogjene (nga vende të ndryshme) e stafit akademik është një risi tjetër që siguron shkëmbime përvojash të ndryshme dhe të nevojshme.
- KyInstitucion, për realizimin me sukses të programit studimor të kësaj dege, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një mori institucionesh homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas e të huaj.

**Këshillojmë** që një marrëveshje e tillë bashkëpunimi, sidomos në çështje të praktikave të përbashkëta profesionale, të realizohet një marrëveshje bashkëpunimi edhe me degën e Turkologjisë së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të Universitetit të Tiranës.

Pas kësaj analize, grupi ynë i vlerësimit konstaton se, Institucioni i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në pikat VII.1 dhe VII. 2.

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me **“Analizën përmbledhëse të RVJ”** sipas metodës **SWOT** (**S**trengths-pikat e forta, **W**eaknesses- pikat e dobëta, **O**pportunities-mundësitë, **T**hreats-pengesat).

**a. Pika të forta:**

1) Stafi akademik i huaj dhe me grada shkencore
2) Partneriteti i fuqishëm ndërkombëtar

**b. Pika të dobëta:**

1) Disa vonesa në procedurën e pranimit të studentëve të huaj, për shkak të zvarritjeve në lidhje me lejet e qëndrimit dhe njohjen e diplomave të shkollës së mesme.
2) Mësimi të gjuhës shqipe, sidomos për të huajt, meriton vëmendje më të madhe.

**c. Mundësitë:**

1) Të shtohen modulet e lëndës së gjuhës shqipe për studentët shqiptarë dhe të huaj.
2) Të rekrutohet staf akademik me përvojë në përputhje me specialitetin e lëndëve të këtij programi studimor.
3) Të punohet më shumë për tekste universitare dhe përditësimin e tyre.

**d. Pengesat:**

1) Meqenëse pjesa më e madhe e studentëve të kësaj dege janë me kombësi të huaj, ekzistojnë vështirësi në plotësimin e dokumentacionit të plotë në kohën e duhur, edhe për shkak të procedurave në institucione të tjera.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**1.Prof.Dr. Ferit Duka** **2.Doc. Dr. Lindita Xhanari**